

Historiku i Dibres

Aty nga shekulli i XI-te eres se re hasim per here te pare emrin Diber ne trajtat: Debor-os dhe Diboros, te cilin gjeografi aleksandrian Klud Ptolemeu e vendos ne koordinatat gjeografike 46°40' gjatesi dhe 40°45' gjeresi.

Sipas ketyre koordinatave Dibra ndodhej ne verilindje te Skampinit(Elbasanit) dhe ne veriperendim te Lyhnidit(Oherit).

Zosimi ne "Historine e re" rreth vitit 410 na e jep ne trajten e Doberes, Thukididi kryeqendren e quan Dobiros, Straboni i vendos ne rrjedhen e siperme te lumit Struma. Shkrimtari romak Plini Sekundi i vendos doberet se bashku me disa fise te tjere pajaone rreze maleve te Rodonit, Skopit dhe Orbelit. Ne shkrimet bizantine u shnderua nga trajta Diboros ne Debri.

Njekohesisht me penestet kohevendes gene dhe Doberet, por meqe te paret gene me te fuqishem, emri I tyre I njohur harroi doberet qe me vone do te shtriheshin ne gjithë Penestine duke I dhene treves emrin e tyre Diber.

Ne nje diplome perandorake, te vitit 1019 te Vasilut te 11-te, Dibra hynte ne arqipeshkopaten e Peshkopise se sotme.

Ne vitin 1040 permendet per here te pare nga Kredano si krahine ne formen e trajtes Debri. Ana Komnena, me 1107, e shkruan po ne trajten e Kredanos.

Ndersa kryepeshkopi i Ohrit, po kete vit, ruan trajten e shkrimtareve Bizantine: Debri.

Shkrimtari bizantin Akrepoliti eshte i pari qe perdori ne vitin 1257 emrin e krahines ne shumes: Dibrat.

Ne mesjeten para turke tre shkrimtare bizantin: Efremi me 1257, Pahymeres me 1259 dhe Kautakuzeni me 1350, na thone se ka ekzistuar : " nje krahine me emrin Diber".

Ne nje dokument te nenshkruar nga Kral Valuaj dhe mbreti i serbeve Miljutin, me 20 Mars 1305 Diber njihet e gjithë krahina. Turqit e quajten " Deber", ndersa sllavet " Debar" e "Dabar". Feliks Petani, me 1502 e quan Dibren "Dibri". Austriaku Han dhe francezet Bozhur e Pukevil permenden dy Dibra: e siperme dhe e poshtme, me 500 shtepi.

Ne defterin turk te vitit 1467 vilajeti I Dibres jepet me 188 fshatra me 75 000 banore . ne fund te shekullit te 18-te Dibra permblidhte 220 katunde me 250 000 banore. Sami Frasheri me 1891 shenon 25 000 banore vetem qyteti I Dibres se Madhe. Ne kohën e Lidhjes Shqiptare te Prizrenit Dibra numeronte 220 000 mysliman dhe 10 000 te krishtere vellezer te nje gjaku. Konsulli Italian ne Manastir Gaetani D'Aragona, me 1902, na jep 52 000 banor, 35 000 ne Diber te Siperme dhe 17 000 ne Reke pa Dibren e Poshtme dhe Golloborden.

Me 1910 rregjistra turk te vilajetit te Bitoles (Manastiri) japin 120 486 banor ne Diber(112 226 mysliman, 8 254 ortodoks dhe 6 katolik) pa Luren dhe Golloborden.

Dibra etnike shtrihet nga bjeshket e Nalta te Sharrit, prej ku fillon te buroje Vardari, 40 km pertej Korabit, pastaj ulet drejt jugut paralel me Drinin e Zi deri sa te takohet nje perpendikulare qe zbret nga malet e Jabllanices, duke bere nje ngjitje drejt veriut. Dibra nga ana topografike mbyllet nga pese qafa ose porta duke I dhene kesaj treve trajtat e nje kalaje natyrale: Qafe-Buell, Qafe Murre, Guri I Kuq ne Lure, Portat e Korabit, ne Duf te Rekes, ne Bizhure te Manastirit dhe mbyllet ne Qafe Studen.

Tradita Popullore na transmeton lokalizimin e Dibres me dy fjale te rimuara: Ne Gjur e Bizhur(ne Lure e Manastir)

Si krahina fqinje kishite Kukësin, Tetoven, Gostivarin, Kercoven, Perlepen, Librazhdin, Matin e Mirditen.

Administrativisht Dibra ndahej ne dy pjese Topallti dhe Malesi.

Ne te paren benin pjese fshatrat qe kishin njohur dhe pranuar sundimin turk dhe paguanin ne te rralle taksa e xhelep, por asnjehere nuk kishin dhene ushtare. Ketu hynin fshatrat qe shtriheshin ne lindje te rruges automobilistike Qafe- Studen Slllove. Ne Malsi hynin fshatrat qe sundoheshin mbi bazen e kanunit te maleve, me bajraktar e pleg, qe kurre nuk i ishin nenshtuar sundimit turk, d.m.thi nuk jepnin taksa e xhelep dhe as ushtare.

Malesia e Dibres ndryshe quhej dhe "Nente Malet" e Dibres e njohur me kete emer qe me shpalljen e "Hatt-I Sherifin" (Manifestin Perandorak) me 1839, ose sic u quajt ky rregull, reformat e Tanzimatit.

Ne kuptimin e mirefillte "nente malet" e Dibres qene nje organizim ushtarak i ndertuar mbi bazen e tradites, si domosdoshteri mbrojtje kunder vershimeve osmane, qe nxirrnin nje sasi te caktuar ushtaresh (forcash te afta per lufte nga cdo "Mal".

Nente Malet e Dibres ishin: Reçi, Dardha, Cidhna, Muhurri, Luznia ne Diber te Poshtme; Gryka e Vogel, Gryka e Madhe, Bulqiza dhe Selishta ne Diber te Eperme. Shpesh "Mal" futesh edhe Golloborda Perendimore.

Sipas situatave qe krijoheshin perfaqesuesit e maleve mblidheshin ne kuvende. Ishin te caktuara dhe vendet ku mblidheshin si tek Varret e Shupenzes, Gjurre te Mazhices, Ferre te Pashes ne Cidhen, Varret e Delihasanit, Pjepi i Eger etj.

Karakteristike e vecante e kuvendit te Maleve ka qene: lenia e hasmerive, falja e xhaqeve dhe lidhja e beses per ti bere balle agresionit kur Dibra sulmohej.

Dibranet kane perballuar luftra te shumta kunder turqve osman, serbeve e deri kunder nazifashizmit. Nga 24 beteja qe zhvilloi Skenderbeu gjithesej, 19 te tilla numerohen ne Diber. " Fushat e Pollogut, te Dibres, te Ohrit, te Domosdoves, grykat e luginat te Drinit, Matit, Shkumbinit qe nga viti 1444-1448, 1450-56; 1462-65 fushat e Ujit te Bardhe(1457), te livdhit prane Ohrit, te Vajkalit(1465)etj u bene sheshi I disfatave te ushtrive osmane".¹ Nente vjet luftuan kunder serbeve(1912-1921).

Dibranet dhane kontribut ne disa kuvende locale e kombetare si ne Lidhjen Shqiptare te Prizrenit 1878, Kuvendin e Ormanices, 1879, Kuvendin e Dibres 1899, Kongresin e Dibres 1909, Kuvendin e Vlores 1912 e tj.

Historigjia Matit

Origjinen e fjales Mat (Matja) e kane studiuar shume studiues e shkencetare, por ende mbetet e papercaktuar qarte prejardhja e saj. Disa besojne se ky emer ka prejardhje biblike, kurse albanologu I njohur N. Jokli shpjegon se emri I krahines vjen nga gjuha shqipe e ka lidhje me fjalen mat`ane (mat`ane lumit, mat`ane bregut).

Ne nje dokument te vitit 1304, ne nje liste anzhuine me emrat e 13 fiseve, permendet edhe ai I Matit ne formen Mateos. Me 1308 nje anonim, duke folur per kufijt e Arbrit, shkruan: " Albani qe eshte ngjitur me Greqine... shtrihet midis Rashes dhe tokave te despotit te Epirit-e gjithë kjo krahine laget prej 4 lumejsh te medhenj si Frenta, Matja, Skumpinus..." Ka edhe dy raste te tjera ku behet fjale per lumin Mat dhe Bregun e Matit sic eshte ai I vitit 1374.

. 1. Fjalori Enciklopedik Shqiptar. Tirane 1985, f. 967

Duke u nisur nga pozita e mbyllur gjeografike, e fortifikuar me male te larta ne te gjitha anet, per sa I perket krahines se Matit, dijetari gjerman George Shtatmyler ka arritur ne kete perfundim: "**Krahina e Matit**, kjo krahine malesore, e cila asht e rrethueme prej malesh te nalta, mund te kudrohjet si nje vend I shkeputun, pse I ka te gjitha kushtet natyrore per te ngele me nje ane. Dhe me te drejte kjo ka qene qysh ne kohet e vjetra e deri sot qendra popullore e vertete e Shqiptarise, qe I ka kundershutumun ndikimit te huej. Prandaj keto kujtime te perqjithshme na japin apriori deshmine se hapsina jetsore shqiptare e hershme ka qene krahina e Matit. Asht e dijtun se nuk mund te mbeshitetemi vetem ne vleften e deshmitve te nxjerruna apriori; por asht nevoja te paraqiten dishmi nji nga nji, te cilat na vertetojne me fakte se kultura romaqe nuk e ka perfshim krahinen e Matit. Keto deshmi mund te provohen ne mbeshitetje te zbulimeve tokstore arkeologjike dhe te tepricave t'emnavet latine".¹

Natyrisht, nje teze e tille nuk mund te jete e vertete, ose eshte vetem pjeserishte e vertete. Prandaj E. Cabej, duke komentuar kete teze thote:

"G. Stadmyler, per arsye historike, gjuhesore dhe te gjeografise se qarkullimit rrugor, arriti ne mendimin qe hapsira jetesore e popullit shqiptar per kohen romaqe- bizantine te hershme do venduar po ne treven e sotme, vecse vetem ne nje pjese te kesaj, d.m.th. ne katerkendeshin midis fushes bregdetare te Shqipterise se Ulet, lugines se Shkumbinit, Lugines se Drinit te Zi dhe Lugines se Drinit te Bardhe, me krahinen e Matit si qender e tij."²

Dihet se kufijte etnike te shqiptareve jane shume me te gjere qe nga veriu e deri ne Pelepones, ne jug. Shkencat shoqerore kane vertetuar se shqiptaret jane pasardhes te ilireve te lashte qe kane banuar ne trevat e gjera te Ballkanit pergjate bregut te Adriatikut. Pra, shqiptaret I kane patur hapësirat jetesore jo vetem ne luginen e Matit, por ne tere trevat e banuara nga paraadhesit e tyre ilire.

1. Hylli I Drites, Nr.1, f.12, v.1942. Perktih, I Karl Gurakuqit; rev.L'EKA,v.1935, f.140-145 dhe 314-326,art. "Mbi historine e Shqipterise" nga Dr. George Shtadmyler; perktih.Buletin USHT, seria Shkencat Shoqerore, Nr.1, v.1962, F.233, art.i B.Becit: "Hulumtime gjuhesore ne Mat".
2. E.Cabej: "Studime Gjuhesore", vol. VI, f.16.Prishtine,1975